

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruksioni i ambjenteve të shërbimit në funksion të Amfiteatrit.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**45212170-8 Punime ndërtimi për ndërtesa argëtimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 13.257.948,75 (trembëdhjetëmilion e dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë presje shtatëdhjetë e pesë) lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Këshilli i Qarkut Tiranëka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**a.***Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP nr.162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

**b.** *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 265.158,97*

**(dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e shtatë) lekë, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

- 2.1.1** Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO ndërkohë që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.2** Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO ndërkohë që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- 2.1.3** Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikatë **SSH ISO 45001:2018 (e vlefshme) ose ekuivalente**. (Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit). Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

## **2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare ( 2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr.1009/2009: “Personat juridikë që*

detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

**2.2.2.**Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi pra jo me e vogël se vlera prej **13.257.949 (trembëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë)** lekë lëshuar nga Autoriteti përkatës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" (i ndryshuar) në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës në procedurat nën kufirin e ulët monetar.

**Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.**

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur -Punë" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimimi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit<sup>1</sup>, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....,

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.:

## KREU II

### KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit i është referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare. Gjithashtu në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në gusht të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

**Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa vlera e përlllogaritur e fondit limit.**

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Kriteri sipas pikes 2.2.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomike duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas parashikimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006. (i ndryshuar). Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma (b) të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), neni 5, pika (c), sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e

qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **6.628.974 (gjashtëmilion e gjashtëqind e njëzet e tetëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **26.515.897 (njëzet e gjashtëmilion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Fatura tatimore për çdo situacion punimesh;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
  
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:
  - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  - Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturën;
  - Akt kolaudimi objekti;
  - Fatura tatimore
  - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera limit e kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete teknike për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuara me ligj si më poshtë:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

**NP-3 A** Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale.

**Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

**NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.

**NS-2 A** Impjante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri mirëmbajtje.

**NS-4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj.

**NS-14 A** Impjante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

- sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe në VKM nr 759, datë 12.11.2014 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (i ndryshuar).

Gjithashtu në mbështetje të Ligjit specifik nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), neni 8 përcaktohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e

materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose europiane... ”

*Kategoritë për punimet e ndërtimit dhe niveli për çdo kategori punimesh zbatimi janë përcaktuar referuar zërave të preventivit të punimeve për këtë objekt, projektit të zbatimit si dhe në mbështetje të plote të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, (i ndryshuar).*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 3	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale	punime suvatimi, punime dyer e dritare, sistemi i ujit te pijshem	A	0-20 milion
NS-1	Punime prishje	Heqje dyer dritare, prishje shtrese pllakash	A	0-20 milion
NS-2	Impjante hidrosanitare,kuzhina, lavanteri mirëmbajtje.	FV,lavaman porcelani,bolier, bide, tuba e rakorderi ujesjellësi	A	0-20 milion
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj.	Punimet, dyer dhe dritare	A	0-20 milion
NS-14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni	Instalime per ndricim, F.V ndricues, percjelles, celesa e priza, kuader ndicimi	A	0-20 milion

**2.3.3** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë

*(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë ).*

**Argumentimi:***Ky kriter është vendosur në mbështetje të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), Neni 77, pika 1, gërma (c) si dhe pika 4 si dhe në mbështetje të nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”( i ndryshuar).*

*Eshtë kërkuar nëpërmjet këtij kriteri përcaktimi nga ana e operatorit ekonomik i drejtuesit teknik të punimeve si pjesë e personelit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për realizimin e kontratës pasi drejtuesi teknik i punimeve do të jetë personi përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin*

e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës referuar pika 2.1 te kreut I te Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” si dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në liçencë të vertetuar me, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa (për 3 muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës) si më poshtë:

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier elektrik 1 (një)

Kriteri sipas pikës 2.3.4 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomike duhet të vetëdeklarojnë se disponojnë stafin inxhinierik sa më sipër.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm inxhinierik referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje te Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pika 6, gërma (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, CV apo qënësia e tyre në listëpagesat e shoqërisë, janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se këta drejtues teknikë janë operativë pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar punonjës të kualifikuar për realizimin e zërave të veçanta të punimeve, të pajisur me dëshmi kualifikimi, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Gusht 2024 – Tetor 2024** minimalisht si më poshtë:

- 1(një) punonjës Teknik ndertimi



- 1(një) punonjës Muratorë
- 1(një) punonjës specialist në punimet me rezinë
- 1(një) punonjës Elektricitistë
- 2 (dy) punonjës Hidraulikë
- 1 (një) punonjës Hidroizolues
- 2 (dy) punonjës për punime në lartësi
- 1(një) punonjës Automakinistë

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ose ekuivalent.
- Për teknikun e ndërtimit të paraqiten edhe diplomat e shkollës së mesme profesionale ose licencat përkatëse.
- Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Tab.1

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve te punes	Nr.certifikates profesionale	Institucioni/Subjekti certifikues

Kriteri sipas pikes 2.3.5 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit si dhe plotësimi të tabelës Tab.1 ku operatorët ekonomike duhet të vetëdeklarojnë se disponojne stafin teknik sa më sipër.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:**Stafi teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me punimet që kërkohet të realizohen të cilat jane punime në ndërtesa, punime rifiniture, hidroteknike, punime elektrike etj. Gjithashtu ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik ose ekuivalente.

**2.3.6** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- a) 1 (një) punonjës i cili të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar).
- b) Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si: 1(një) Punonjës- Auditues Energjie (i pajisur me certifikate për auditimin e energjisë).

- c) Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si: 1(një) Punonjës ekspert zjarrfikës i certifikuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi lëshuar nga MZZH.

*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit, me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma (c), si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve.

Për sa më lart, punonjësi i cili duhet të jete certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Kërkesa për punonjes Auditues energjie wshtw vendosur nw bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Ligji nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë” përcakton se “**Auditim energjistik**” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/se instalimi privat, me qëllim identifikimin dhe përlllogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efincencës së energjisë. “Përmirësimi i efincencës së energjisë” është rritja e efincencës në përdorimin fundor të energjisë, si rezultat i ndryshimeve teknologjike dhe /ose sjelljeve ekonomike. Auditimet energjitike të detyrueshme kryhen: b) çdo herë përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objekte të tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm. Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë një auditues energjie me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme për konsumin e energjisë në objektin që do rikonstruktohet, identifikimin dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efincencës së energjisë.

Në nenin 9 pika 1 të ligjit nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë” parashikohet se: “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përfshin në rregullat e prokurimit publik parashikime, të cilat detyrojnë autoritetet kontraktore që të përcaktojnë në dokumentet e procedurave të prokurimit të pajisjeve apo produkteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, specifikime teknike, që përmbushin kërkesat minimale të efincencës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë.

Kërkesa për Punonjës ekspert zjarrfikës wshtw vedosur nw mbwshtetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar),

me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit si dhe mbështetur në natyrën e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, për nga vetë rëndësia e objektit që do të prokurohet duke qënë se kemi të bëjmë me punime në ndërtesa, duhet që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij një ekspert zjarrfikës të certifikuar për të organizuar punët dhe për të mundësuar nëçdo kohë (nëpermjet plan organizimeve të punës) korridore kalimi të mjeteve kundra zjarrit (zjarrfikëse, autoshkallët etj) në rast rënie zjarri në objektet që preken në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga zbatimi i projektit si dhe të bëjë instruksionet e nevojshme për rast rënie zjarri.

**2.3.7** Numri mesatar i punonjësve duhet të jetë jo më pak se **10 (dhjetë) punonjës** për periudhën **Gusht 2024 – Tetor 2024**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Gusht 2024 – Tetor 2024**.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Gusht 2024 – Tetor 2024**.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit 2.3.8**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht, ligji nr. 8402, datë 19.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar dhe VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përlloraritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përlloritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ. Nga përlloraritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve 120 ditë duhen 4 punonjës me sa më poshtë sqaruar në tabelë dhe argumentuar nga njësia e prokurimit:

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORE PUNE	ORE PUNE GJITHSEJ
		<b>1. PRISHJE</b>				
1	2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim	m3	7.0	6.20	43.40
		<b>Shuma 1:</b>				<b>43.40</b>
		<b>2. PUNIME MURATURE TULLE</b>				
3	2.108/1c	Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires	m2	42.0	3.59	150.78
4	2.108/1a	Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa	m2	34.0	3.59	122.06
		<b>Shuma 2:</b>				<b>272.84</b>
		<b>3. PUNIME SHTRRESASH 2</b>				
5	2.264	Shtrese lluster cemento 1:2	m2	275.0	0.66	181.50
6	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	8.0	8.60	68.80
		<b>Shuma 3:</b>				<b>250.30</b>
		<b>4. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE</b>				
7	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	275.0	1.00	275.00
		<b>Shuma 4:</b>				<b>275.00</b>

<b>5. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE</b>						
8	2.495/1	Heqje lavaman	copë	4.0	0.26	1.04
9	2.501/1	Heqje WC + kasete	copë	4.0	0.32	1.28
10	2.494/1	F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	copë	14.0	1.20	16.80
11	2.508	F.V bolier 100 l	copë	4.0	2.10	8.40
12	2.515	F.V pilete dyshemeje Ø 50	copë	6.0	1.70	10.20
13	2.501	F.V WC allafrenga	copë	6.0	3.70	22.20
14	2.491/c	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16	ml	217.0	0.30	65.10
15	2.491/e	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16	ml	165.0	0.30	49.50
<b>Shuma 5:</b>						<b>174.52</b>
<b>6. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI</b>						
16	2.310	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2	150.0	1.55	232.50
17	2.297/a	Veshje tavani me kartonxhes	m2	182.0	2.10	382.20
18	2.328/1	Patinim muri me stuko	m2	583.0	0.92	536.36
<b>Shuma 6:</b>						<b>1,151.06</b>
<b>7. PUNIME BOJATISJE</b>						
19	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	583.0	0.36	209.88
<b>Shuma 7:</b>						<b>209.88</b>
<b>8. INSTALIME PER NDRICIM</b>						
20	2.481/1	F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	900.0	0.04	36.00
21	2.481/2	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	1500.0	0.04	60.00
22	2.481/3	F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml	301.0	0.04	12.04
23	2.485	F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	100.0	1.00	100.00
24	2.486	F.V Portollampa norm 10 A	copë	40.0	0.55	22.00
25	2.490	F.V kuader ndrçimi	copë	4.0	3.10	12.40
26	2.496	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m	copë	4.0	0.30	1.20
27	2.500	F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur	ml	100.0	0.05	5.00
28	2.469	F.V. Ndricues tip spot me llampa fluoreshente,2x18w	copë	142.0	1.20	170.40
29	2.466	F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x40w	copë	5.0	1.20	6.00
30	2.480/2	F.V tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	200.0	0.32	64.00
31	2.480/5	F.V tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	20.0	0.43	8.60
<b>Shuma 8:</b>						<b>497.64</b>
<b>9. PUNIME DYER DRITARE</b>						
32	2.391	Heqje dyer ekzistuese	m2	7.0	1.20	8.40
<b>Shuma 9:</b>						<b>8.40</b>
<b>10. ANALIZA JASHTE LISTE</b>						
33	AnAn	F.V HPL Tualetet (6 dyeresh)	copë	1.0	12.50	12.50
34	AnAn	F.V lavamane mikro cement me dy gropa (permasa 147x50)	copë	2.0	2.95	5.90
35	AnAn	F.V lavamane mikro cement me dy gropa (permasa 164x50)	copë	1.0	2.95	2.95
36	AnAn	F.V lavamane mikro cement me nje grope (permasa 100x50)	copë	1.0	2.95	2.95
37	AnAn	F.V lavamane mikro cement me nje grope	copë	1.0	2.95	2.95
38	AnAn	F.V Mishelator Lavamani Negro Urban	copë	8.0	0.66	5.28
39	AnAn	F.V grupe dushi	copë	5.0	2.10	10.50
40	AnAn	F.V set paisjesh tualeti per njerzit me aftesi te kufizuara	copë	1.0	7.50	7.50
41	AnAn	F.V. Ndricues tavani led me Struktur metalike	copë	3.0	1.20	3.60
42	AnAn	Montim Kondicioner multisplit (3+1)	copë	1.0	2.50	2.50
43	AnAn	F.V Dyer mdf rimeso lisi 90cm x 210cm	copë	9.0	0.66	5.94
44	AnAn	F.V Dyer mdf me lyerje 70cm x 210cm	copë	2.0	0.66	1.32
45	AnAn	Shtresë me rezinë perfshire autonivelantin per dyshemete sikaflor 151/264 ose ekujvalent	m2	228.0	0.92	209.76
46	AnAn	Veshje e mureve me rezine me baze uji, sikaflor 2540 wallcoat ose ekujvalent	m2	350.0	0.92	322.00
47	AnAn	Kabëll bakri fleksibël FG7(O)R 2x1mm²	ml	200.0	0.05	10.00
48	AnAn	F.V.Kabëll sinjalizimi TR 1x2x0.8mm	ml	200.0	0.05	10.00
<b>Shuma 10:</b>						<b>615.65</b>
<b>11. PUNIME MOBILIMI</b>						
70	AnAn	F.V veshje muri me Rimeso Lisi (380cm x270cm)	copë	1.0	2.80	2.80

71	AnAn	F.V veshje muri me Rimeso Lisi (310cm x270cm)	copë	1.0	2.80	2.80
72	AnAn	F.V veshje muri me Rimeso Lisi (300cm x270cm)	copë	1.0	2.80	2.80
73	AnAn	F.V veshje muri me Rimeso Lisi (76m x270m)	copë	1.0	2.80	2.80
		<b>Shuma 11:</b>				<b>11.20</b>
		<b>12. PAJISJE</b>				
74	Pj	F.V. buton sinjalizimi me dore	copë	2.0	1.20	2.40
75	Pj	F.V.sirene alarmi	copë	1.0	2.50	2.50
76	Pj	Sinjalistike Klase e Zjarrit A	copë	9.0	0.10	0.90
77	Pj	Sinjalistike Klase e Zjarrit C	copë	2.0	0.10	0.20
78	Pj	Sinjalistike Rrezik Tensioni i Larte	copë	2.0	0.10	0.20
79	Pj	Sinjalistike Ndalim I shuarjes me uje	copë	2.0	0.10	0.20
80	Pj	Detektor tymi	copë	11.0	2.50	27.50
81	Pj	Sinjalizues tymi	copë	11.0	0.55	6.05
82	Pj	F.V Fikese zjarri me bombel pluhur dhe CO2 (ALn5203nB)	copë	2.0	1.40	2.80
83	Pj	F.V Fikese zjarri me karrel me pluhur dhe CO2 (ALn5203nB)	copë	2.0	1.40	2.80
		<b>Shuma 12:</b>				<b>45.55</b>
<b>Shuma ( 1-12 ) ore pune</b>						<b>3,555.44</b>
<b>Ore Pune Per 120 Dite pune</b>						<b>960.00</b>
<b>Puntori (120 dite pune)</b>						<b>3.70</b>

Gjithashtu në funksion të realizimit të kontrates jane kerkuar nga autoriteti kontraktor 3 punonjës inxhinierë drejtues teknik të shoqërisë, 1 person auditues energjie, një punonjës ekspert zjarrëfikës dhe punonjës administrate të cilët po ti shtohen numrit të punëtorëve të përcaktuar sipas tabelës përbëjnë numrin në total prej **10 punonjës** të nevojshëm për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialin:

- Rezine

Per materialin sa mw sipwr OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohet materiali që do të ofrohet.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), në nenin 39, pika 8, si dhe në mbwshtetje të nenit 45, pika 1 të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar). Kjo kerkese ka qllim ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë materialet e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojë qe specifikimet teknike te mallrave te propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: skedat teknike apo katalogwt me qëllim përmbushjen e kwtyre standarteve. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për materialin rezine si material specifik qw do tw përdoret në këtë objekt. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi,skeda teknike ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se materiali qw që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kerkeseve te projektit. Plotesimi i kerkeses me siper garanton Autoritetin Kontraktor per cilesine e materialit.

**2.3.9** Në rastin kur OE nuk është prodhues i produkteve/ artikujve të mobilerise, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga prodhuesi, për mobiljet që do ofertojë.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, eëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 77 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar . Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), në nenin 39, pika 8, si dhe bazuar në faktin që në këtë kontratë janë parashikuar dhe zërat e mobilimit për amfiteatrin.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara mobilje , e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve mobilje (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre, për paisjet që kanë defekte nga prodhimi.

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

**2.3.11** Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamioncinë kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	në pronësi ose qira	copë	1
2	Skele inventari	në pronësi ose qira	m2	6
3	Vinc kulle	në pronësi ose qira	copë	1
4	Elektro argano	në pronësi ose qira	copë	1
5	Matrapik	në pronësi ose qira	copë	1
6	Depozitë uji 1000 l	në pronësi ose qira	copë	2
7	Pompë uji	në pronësi ose qira	copë	1

- a) Për mjetet që regjistrohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, Çertifikatën e pronësisë, dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumentet e mësipërme duhet të shoqërohen me kontratën noteriale përkatëse të qerasë, e

vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese dhe foto, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë noteriale e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. Për pajisjet me numrat rendorë 19, 20 duhet të paraqitet certifikatë e vlefshme e kalibrimit.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkruara do të angazhohen në këtë objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjatë vleresimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- e) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- f) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

### **Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit**

Dokumentacioni provues, i cili vërteton se operatori ekonomik disponon mjetet sa më sipër, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit **Argumentimi**. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetojë se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike, preventivat janë përgatitur nga projektuesit në përputhje me legjislacionin në fuqi bazuar në natyrën e punëve.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*